Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 3 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsioni, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i panjohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejmë KSHPK), në seancën e 82-të të mbajtur më 14.02.2023 ka miratuar si në vijim.

## Vendim

Veprimi sipas denoncimit me numër 12-4277/1 të datës 28.04.2022, **NDËRPRITET.**

KSHPK-ja përcaktoi se lënda nuk ka elemente për veprim kompetent të mëtutjeshëm

Lënda me numër 12-4277 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi të publikohet në formë të depersonalizuar në ven faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pes) ditëve nga dita e miratimit.

## Arsyetim

Lënda me numër 12-4277/1 datë 28.04.2022 është formuar në bazë denoncimit të dorëzuar nga një parashtrues i panjohur, i cili fillimisht është dorëzuar në Byronë e Prokurimit Publik të RMV-së, nga ku i është përcjellë KSHPK-së për veprim kompetent. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për funksionim të pakujdesshëm dhe asgjësim të fondeve buxhetore në /// nga një zyrtar ///, drejtor. Pa dokumentacion janë paguar para për transport nga llogaria e transaksionit të subjektit që ai drejton dhe është angazhuar kompania ///, e cila transportonte nxënësit nga dhe në shkollë me automjete të dyshimta, automjetet nuk kishin mbishkrim në çati se ata ishin punime për transport me taksi dhe nuk ishte përdorur as fugoni që ishte blerë ekskluzivisht për transportin e nxënësve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e RMV-së. KSHPK-së i kërkohet rishqyrtimi i çështjes në përputhje me kompetencat e saj ligjore, përveç kërkesës nuk është paraqitur asnjë provë.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit, KSHPK-ja ka kërkuar veprime kompetente, të dhëna, informacione dhe dokumentacion nga subjekti i lartpërmendur dhe nga MPB-ja e RMV-Sektori i Punëve të Brendshme Manastir, ndërsa nga këqyrja e të dorëzuarve nuk ka asnjë element për veprime të mëtejshme. Në rastin konkret, sipas njoftimit të MPB-së së RMV-së, Departamenti i Punëve të Brendshme Manastir, pas kontrolleve të kryera nga ana e tyre, nuk janë konstatuar veprime të kundërligjshme dhe parregullsi.

Sipas sa më sipër, DHPGJS-ja vendosi si në dispozitiv.

Dorëzuar:
- Arkivi i KSHPK-së

Përgatiti: Mr. D:D м-р Д. Д.
Miratoi: Mr. SH.S м-р Ш. С.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
Nënkryetare,
Katica Nikolovska

Адреса: ул. Пресвета Богородица број 3, 1000 Скопје - Република Северна Македонија
Adresa: rr. Presveta Bogorodica nr.3, 1000 Shkup - Republika e Maqedonisë së Veriut
email: contact@dksk.org.mk
тел/tel: +389 2 3248 930
https://www.dksk.mk